

Alva DANI
Faculty of Foreign Languages
“Luigj Gurakuqi” University
Shkodër, Shqipëri
E-mail: alvadani2001@yahoo.it

**PËRKTHIMET SI NJË KONTRIBUT TJETËR I ÇMUAR I REVISTËS
“SHEJZAT”
TRANSLATIONS AS ANOTHER PRECIOUS CONTRIBUTION TO THE
“SHEJZAT” MAGAZINE**

Hyrje

Revista “Shejzat” konsiderohet edhe sot nga të gjithë si një vlerë e çmuar e letërsisë sonë shqipe, si një kontribut i disa viteve dhe i disa emrash të njohur studiuesish dhe albanologësh, të cilët me shumë përkushtim e dashuri për albanologjinë e bënë atë të njohur për shumë ambiente të huaja letrare dhe jo vetëm. Përtej vlerave letrare dhe gjuhësore, të cilat janë bërë objekt i mjaft studimeve të mirëfillta, duhet pranuar si një tjetër vlerë edhe fusha e përkthimit, megjithëse e lëvruar në këtë revistë nga një numër i kufizuar studiuesish me shumë emër.

Vetë emri i revistës në çdo numër të saj vjen në dy gjuhë: shqip dhe italisht (*Shejzat* dhe *Le Pleiadi*). Veç kësaj ajo që bie në sy edhe me një shfletim të thjeshtë janë edhe titujt, të cilët në përmbajtje të revistës shoqërohen pothuajse gjithmonë me përkthimet përkatëse në italisht, në kllapa. Gjuha nga e cila përkthehen pjesët e në të cilën përkthehet më së shumti është gjuha italiane. Kjo bëhet e qartë për faktin se kjo revistë botohet në Itali, në Romë që nga viti 1957 kur del numri i parë i saj deri në vitin 1974, kur del numri i fundit, me përjashtim të numrit të vitit 1978, që është një numër përkujtimor kushtuar Ernest Koliqin, drejtuesit të saj

gjatë gjithë këtyre viteve. Përveç gjuhës italiane, shkrimet botohen edhe në gjuhë të tjera e kryesisht në gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht.

Përkthimet nga italishtja dhe në italisht

Nëse do të bënin një ndarje të kontributit nga secila gjuhë, në mënyrë të natyrshme do të gjejmë një pasuri shumë më të madhe përkthimesh të sjella nga gjuha italiane dhe kryesisht nga shkrimtari dhe studiuesi Ernest Koliqi. Ai duke qenë themelues i kësaj reviste, duke qenë njohës shumë i mirë i letërsisë italiane, i gjuhës dhe qytetërimit italian solli përkthime autorësh shumë të njohur, në mënyrë që edhe shqiptarë të tjerë të njihnin prurjet e kësaj letërsie fqinje.

(a) Që në numrat e parë të viti 1957 gjejmë shkrimtarë të tillë si **Giosue Carducci**, nga i cili me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së tij sjell poezitë *Mattinata* (Këngë mëngjesi), *Davanti San Guido* (Përpara Shën Gvidos), *Il comune rustico* (Bashkija fshatare), dhe *Canto di marzo* (Kangë marsi).

Vijon në numrin 1-2 të vitit 1958 **Gabriele D'Annunzio** me përkthimet e Koliqit *Mbramje fjezolane* dhe *Gjatë Afrikut në një mbramje qershori mbas shiut*. Ky shkrimtar përzgjidhet përsëri nga Koliqi, për t'u botuar në numrin e vitit 1963 në disa faqe me poezi si: *Kndojn puhinat...*, *Nga kupa e revet...*, *O drapën i hanës...*, *O Rini, Dhanti e tmerrshme, Shtrojet, Zgjimet, Shiu në pyll pishash, Pra agimit dhe Barijt*. Duhet thënë se kjo përzgjedhje nuk është aspak e rastësishme, pasi D'Annunzio do të përbënte për Koliqin dhe artin e tij të shkruarit një pikë referimi tepër të rëndësishme, një mjeshtër të vërtetë që do t'i tregojë bukurinë dhe forcën e fjalës, do t'i mësojë burimin e vërtetë të fjalës së pastër, atë që vjen vetëm nga goja e popullit, atë që fshihet e paprekur mes maleve e bjeshkëve të larta të vendit të tij.

Një tjetër emër i njohur i letërsisë italiane është **Giovanni Pascoli**, me rastin e 50-vjetorit të të cilit përkthen një sërë poezish, nga më të njohurat e krijimtarisë së tij si: *Qepesja, Fides, Lavrojn arat, Bumbullima, Pelëza qime Imijet e thija - thija* e *Solon*. Në nr 9-10 të vitit 1965 vijojnë përkthimet e arrira të Koliqit, duke veçuar këtë herë poetin e madh të kombit italian e jo vetëm **Dante Alighierin**, me rastin e shtatëqindvjetorit të vdekjes. Lirikat e zgjedhura janë marrë nga *Vita Nuova* dhe *Rime*.

*Donne che avete intelletto d'amore
Tanto gentile e tanto onesta pare
Deh peregrini che pensosi andate
Rime*

Guido, i'vorrei che tu e Lapo ed io

*O gra qi mirni vesh nga dashunija
Aq e njerzishme edh'aq e hijshme ndanë
O shtegtar qi në heshtje ndry n'vetveti*

Guido un' kisha me dasht' qi ty dhe mue

Per una ghirlanetta...

Për një kunorëz lulesh

Sonar braccetti, e cacciatori aizzare

Zagar ‘tue leh’, gjahtar’ n’ ngucje t’u orvatë

Duke ndjekur numrat me radhë shohim se edhe në 1968-n Koliqi përkthen pjesë nga *Salvatore Quasimodo*, një tjetër autor i njohur italian e konkretisht poezitë: *Dhe arrin mejhera mbramja, Erë në Tindari, Tash qi drita po zbardhë, Engjulli, Njeri i kohës s’ime*.

Përkthyes të tjerë nga gjuha italiane që dhanë kontributin e tyre përmes faqeve të kësaj reviste ishin edhe emrat e njohur të Vinçens Prenushit dhe Pashko Gjeçit, me pjesë të përkthyer nga *Divina Commedia* e Dantes, apo Martin Camaj që sjell disa poezi nga poeti hermetik i Nëntë-qindës italiane Giuseppe Ungaretti. Karl Gurakuqin gjithashtu e shohim si përkthyes nga gjuha italiane duke zgjedhur Ettore Parattoren me *Liriche adriatiche* dhe pjesën *Dy shpirtinat e njij poeti*.

(b) Përveç përkthimeve në gjuhën shqipe, Koliqi solli edhe mjaft përkthime të pjesëve shqipe, në gjuhën italiane, duke bërë të njohur për lexuesin italian shumë pjesë të **rapsodive e rapsodëve** të Alpeve shqiptare, shumë tregime e përralla, të cilat shpalosin vlerat e mira shqiptarit, zakonet e varietetet e tij të jetesës, si një popull shumë i vjetër i Ballkanit. Këtu mes të tjerash mund të veçojmë *Dasma e Halilit* (Le nozze di Halil), Këngë të ndryshme nga *Lahuta e Malësisë* (Liuto delle Montagne), poezi të Naim Frashërit, *Novelle romantiche di Girolamo De Rada*, apo pjesë nga Çajupi, *Sposo a quattordici anni*.

Madje në *Shejzën* e vitit 1973 sjell një **përmbledhje me lirika** të shkrimtarëve më të mirë shqiptarë, duke i quajtur *Piccola antologia di Shejzat* duke spikatur emra si: Girolamo De Rada, Naim Frashëri, Çajupi, Fishta, M. Camaj, Latif Berisha, Rexhep Hoxha e Azem Shkreli.

Ndër përkthyesit e tjerë nga gjuha shqipe në atë italiane që dha një kontribut të rëndësishëm për afirmimin e letërsisë shqiptare përmes faqeve të kësaj reviste është edhe albanologu Giuseppe Gardilone me përkthimin e *Skenderbegut të pafan* të Jeronim De Radës (Lo Scanderbeg disavventurato).

Përkthimet e letërsisë shqipe në frëngjisht

Mbas gjuhës italiane, vijnë përkthime të bëra në gjuhën frënge dhe emri që garanton cilësinë e këtyre përkthimeve është Faik Konica. Ai përkthen pjesë nga letërsia popullore shqiptare, nën titullin “Litterature albanaise par Faik Konica”. Këto pjesë shoqërohen me shënimin *marrë nga revista “Albania”, Bruxelles, 1897*. Që në numrin e parë të revistës *Shejzat* botohet në frëngjisht *Une rapsodie albanaise*, duke u shoqëruar pastaj në

shumë prej numrave të saj nga *Chants populaires*, apo nga tituj të tjerë si *Documents sur le folklore albanaise e Traditions populaires d'Albanie*.

Faik Konica përkthen në frëngjisht edhe Mili e Hajdhia e **Zef Skiroit** që vazhdon në numrat 5-6 e 7-8 të vitit 1961 dhe numrat 5-6 të vitit 1962. Jo pa qëllim Konica zgjedh pjesë nga letërsia popullore shqiptare, sepse kjo do të ishte mënyra më origjinale për t'u treguar të huajve karakterin dhe moralin shqiptar, në gjithë autenticitetin e vlerave që mbartin.

Përkthimet nga gjermanishtja

Një sërë përkthimesh pasojnë edhe nga gjuha gjermane e nga emra të njohur si Karl Grakuqi e Martin Camaj, apo edhe emra të tjerë si Anesti Andrea dhe Rexhep Krasniqi. Një vend të rëndësishëm në faqet e kësaj reviste zë kryesisht studimi i gjatë i albanologut Franz Babinger, *Pinjollit i fundit i familjes s'Arvanitasve*, i shtrirë në disa numra, duke filluar nga 11-12 e vitit 1960, duke vazhduar me 1-2, me 3-4, me 7-8, 9-10 e vitit 1961, 3-4 e 5-6 e 9-10 e vitit 1962, e për të vazhduar pastaj me numrat 1-2, 3-4, e 9-10 të vitit 1963. Në një numër tjetër vjen studimi *Homeri dhe epopeja shqiptare* e Maxmilian Lambertz apo *Gjergj Kastrioti Skenderbeu* i Alois Schmaus.

Përkthimet nga gjuha angleze në shqip dhe anasjelltas

Nuk mungojnë në këtë revistë as përkthimet nga gjuha angleze. Përmendim emra përkthyesish si Bill Stivens, që sjell në 1958-n *Vrasësit* e Heminguejt, pastaj në 1962 përkthen nga letërsia amerikane *Qysh na hiku Emma Inch* nga James Turber. Bendo Shapërdani përkthen *Skanderbeg* e Padriac Colum. Në numrin 9-12 të 1972-shit.

Anesti Andrea përkthen në anglisht *The simphony of eagles* të Ernest Koliqit (Simfonia e shqipeve).

Përkthimet nga gjuhë të tjera dhe anasjelltas

Duke shfletuar revistën gjejmë edhe përkthime nga gjuha arabe, gjuha ruse dhe ajo suedeze. Një fakt që tregon për një gjithëpërfshirje kulturash, letërsish e besimesh, një dimension i gjërë që merr kjo revistë edhe falë përkushtimit të përkthyesve të shumë gjuhëve.

Në katër numra me radhë gjejmë pjesën *Banuesit e shpellës*, e shkruar nga Teufik El-Hakim dhe e përkthyer nga **arabishtja** nga Imam Vehbi Ismaili.

Në numrin e parë të viti 1969 botohet pjesa *Besa* e **N. P. Mamontov** e përkthyer nga **rusishtja** nga Angelo De Genti. Ky përkthim do të ishte mjaft interesant pasi në qendër të tij do të vihej madhështia e besës

shqiptare, e cila e shkruar në rusisht do ta bënte atë të njohur për një masë edhe më të gjerë njerëzish. Redaksia në një shënim shkruan “Cilsija shqiptare e mikpritjes, po u zhvillue në dritë e ne nxehtësi të qytetnimit, mundet me ngjitun një njeri shumë nalt në shkallë të vërtyteve ma të spikatuna njerzore. Një popull me ndjesi të tilla asht i pjekun me marrë pjesë lumnisht në bashkëjetesë me popuj tjerë” (f. 148).

Nga rusishtja përkthen edhe shkrimtari i njohur Martin Camaj. Në 1958 përkthen nga **Mihail Zoshçenko**, *Nji lojë e rrezikshme*, ndërsa në numrin e 1959-ës sjell nga **Boris Pasternak** *Udhëtimi i fundit i doktor Zhivagos*.

Nga gjuha **suedeze** gjithashtu kemi disa poezi me titull “Ujdhesa e Lumtunis” për Daniel Amadeus Atterbom, me përkthyes Kosovë Rexha-Bala. Duhet thënë se shumë prej këtyre përkthimeve mbeten vetëm në faqet e kësaj reviste, si një kontribut i çmuar vetëm i saj.

Përmbledhje:

Përkthimet zënë një vend shumë të rëndësishëm në revistën “*Shejzat*”. Ato përbëjnë një nga kolonat e rëndësishme ku mbështetet kontributi i saj që prej themelimit e deri në mbyllje (1957 – 1978). E botuar në gjuhën shqipe në Itali, arriti të sillte një numër të madh përkthimesh, kryesisht nga gjuha italiane. Emra shkrimtarësh të mëdhenj shfaqen edhe si përkthyes shumë të mirë në gjuhën shqipe, duke treguar shumë kujdes e maturi edhe në përzgjedhjen e tyre. Bie në sy emri i Ernest Koliqit për përkthime të shumta nga italishtja dhe frëngjishtja, emri i Martin Camajit, Pashko Gjeçi për përkthimet e çmuara të Dantes, Faik Konica me përkthimet në frëngjisht apo Karl Gurakuqi nga gjermanishtja dhe italishtja. Shumë emra të tjerë të njohur shoqërojnë këtë listë përkthyesish dhe kontribuesish në këtë fushë. Përkthimet janë të shumta dhe përbëjnë një vlerë të çmuar që i shtohet kontributit të jashtëzakonshëm të revistës “*Shejzat*”.

Fjalë çelës: Shejzat, revistë, përkthime, kontribut, italisht, shkrimtar

Abstract:

Translations occupy an important place in “*Shejzat*” magazine. They are considered as one of the most important pillars on which its contribution is based from its opening to its closure (1957 – 1978). Published in Albanian in Italy, it managed to bring a great number of translations, mainly in Italian. Names of notourious Albanian writers appear even as very talented translators in Albanian , paying great attention and maturity to their selection. We can notice Ernest Koliqi’s name for his numerous translations from Italian and French, Martin Camajand, Pashko Gjeçi’s names for their priceless translations of Dante’s works, Faik Konica’s name for his translations from Albanian into French or Karl Gurakuqi’s name from German and Italian. There are a lot of other notorious names that follow this list of translations and contributors in this domain. These precious and numerous translations are added to the extraordinary contributions of “*Shejzat*” magazine.

Keywords: Shejzat, translations, contribution, italian, writers